REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE
Nr./Br./No: 01-2004
Data/Datum/Date: 29.12.2025
Shtojca/Dodaci/Annex: 2
PRISHTINË/A

Nr/Br/No: 2575 Data/Datum/Date: 29.12.25

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Prevde - Ministry of Justice*

*Kabineti i Ministrit - Kancelarija Ministra - Cabinet of the Minister*

---

Nr.448/2025
Datë:29/12/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) nenit11, nenit 29 dhe nenit 30 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (GZ, Nr. 7/01 mars 2019), në bazë të nenit 11 (paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5) të Ligjit Nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në përputhje me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, si dhe në pajtim me Shtojcën 1 (pika 3) të Rregullores QRK-Nr.14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ushtruesi i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë, nxjerr këtë:

## VENDIM

1. Miratohet Plani i Performancës së Shërbimit Korrektues të Kosovës për Vitin 2026.

2. Obligohet Shërbimi Korrektues i Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Blerim SALLAHU

Ushtrues i Detyrës së Ministrit të Drejtësisë

*Vendimi iu dërgohet:*

- *Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme;*
- *Anëtarëve të njësisë përgjegjëse;*
- *Drejtorit të Shërbimit Korrektues të Kosovës, z. Ismail Dibrani;*
- *Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.*

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

*Ministria e Drejtësisë -Ministarstvo Pravde -Ministry of Justice*
*Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service*

---

**SHËRBIMI KORREKTUES I KOSOVËS**

# PLANI VJETOR I PERFORMANCËS PËR VITIN 2026

Tetor, 2025

# Hyrje

Bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura si dhe dispozitat relevante të Rregullores (QRK) Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, Shërbimi Korrektues i Kosovës, agjenci ekzekutive e sigurisë në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë ka hartuar Planin e Performancës për vitin 2026.

# Misioni

Misioni i Shërbimit Korrektues të Kosovës përfshin funksionet e kontrollit dhe përgjegjësisë për administratën e sistemit korrektues dhe ekzekutiv në Kosovë. Kjo përfshin mbikëqyrjen e burgjeve dhe institucioneve të tjera korrektuese, si dhe ofrimin e shërbimeve rehabilituese për personat që janë nën kontrollin e këtyre institucioneve.
Një nga qëllimet kryesore të Shërbimit Korrektues është sigurimi i trajtimit të drejtë dhe të barabartë të personave të burgosur, duke përmirësuar kushtet e tyre jetike dhe duke ofruar programe rehabilituese që ndihmojnë në rikthimin e tyre në shoqëri pas lirimit si dhe e respektimit të të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e sistemit korrektues në përgjithësi.

# Objektivat

Bazuar në nenin 6, paragrafi 2.2.5 të Rregullores Nr. 12/2023 mbi Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, Shërbimi Korrektues ka paraqitur katër (4) objektiva lidhur me Planin e Performancës për vitin 2026 të cilat janë vlerësuar që janë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të afatizuara.
Përmes tyre janë adresuar sfidat specifike me qëllim për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve, kënaqshmërinë e qytetarëve si dhe efektivitetin dhe efikasitetin e aktiviteteve të Agjencisë.

- *Risocializimi dhe rehabilitimi i të burgosurve përmes trajnimeve, programeve të reja dhe programeve aktuale;*
- *Zhvillimi i profesional i personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Ndërtimi dhe renovimi i objekteve të Shërbimit Korrektues të Kosovës;*
- *Ngritja e nivelit të sigurisë.*

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Data: | 31/10/2025 | | | | | | | |
| AGJENCIA | Shërbimi Korrektues i Kosovës | | | | | | | |
| MINISTRIA PËRGJEGJËSE | Ministria e Drejtësisë | | | | | | | |
| *Misioni i Agjencisë* | Shërbimi Korrektues i Kosovës synon të korrektojë dhe risocializojë të burgosurit duke respektuar të drejtat e tyre fundamentale pa diskriminim si dhe siguron një ambient të sigurt për stafin, të burgosurit dhe shoqërinë. | | | | | | | |
| **Objektivat** | **Treguesi(t)** | **Vlera bazë** | **Vlera e synuar** | **Outputet** | **Aktivitetet kryesore** | **Alokimi financiar** | **Referenca në dokumente strategjike/politike** | |
| 1. Risocializimi dhe rehabilitimi i të burgosurve përmes trajnimeve, programeve të reja dhe programeve aktuale | Numri i raporteve të vlerësimit të rrezikut dhe nevojave të hartuara | % e të dënuarve të pranuar | 100% të dënuarve me burgim efektiv të pranuar | Raporti, i cili vlerëson rreziqet dhe nevojat | Hartimi i raportit për vlerësimin e rreziqeve dhe nevojave për të gjithë të burgosurit e dënuar me burgim efektiv | Kosto Administrative | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, Ligji nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës | TM4 |
| | Numri i planeve individuale të dënimit të hartuara | % e të dënuarve të pranuar | 100% e të dënuarve me burgim efektiv të pranuar | Planet individuale të hartuara | Hartimi i planeve individuale për vuajtjen e dënimit duke u bazuar në të dhënat e vlerësimit të rreziqeve dhe nevojave për të | Kosto Administrative | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, Ligji nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës | TM4 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | gjithë të dënuarit | | | |
| | Numri i të burgosurve që kanë marr pjesë në programe | 50% e të dënuarve | 20% e të dënuarve | Pjesëmarrja e të dënuarve në programe rehabilituese | Mbajtja e programeve rehabilituese | Kosto Administrative | Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026 | TM4 |
| 2. Aftësimi profesional i personelit të Shërbimit Korrektues të Kosovës | | | | | | | | |
| | Hartimi i programit të ri trajnues për personelin për tu përshtatur me ndryshimet e fundit ligjore | | Hartimi i programit trajnues | Programi i miratuar | Hartimi i programit të ri trajnues. | Kosto administrative | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 | TM1 |
| | Aftësimi profesional i personelit lidhur me programin e ri trajnues për përshtatje me ndryshimet | 0% personel i trajnuar në këtë program | 15% e numrit total të personelit të SHKK (1700) | Zyrtarë të trajnuar | Realizimi i programit të ri trajnues | Kosto administrative | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 | TM2 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | e fundit ligjore | | | | | | | |
| | Certifikimi i zyrtarëve për çështje sociale dhe programe në zabtimin e programeve rehabilituese për të burgosur | Pesë (5) zyrtarë të certifikuar | 20 zyrtarë të certifikuar | Zyrtarët e certifikuar | Përfundimi i trajnimit dhe certifikimi i zyrtarëve | Kosto administrative | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 | TM3 |
| | Trajnimi për siguri dinamike për zyrtarët korrektues | 1395 zyrtarë korrektues | 100 zyrtarë korrektues | Zyrtarët e trajnuar | Përfundimi i trajnimit bazik për zyrtarët korrektues | Kosto administrative | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026, Plani vjetor i personelit për vitin 2025 | TM3 |
| | Numri i zyrtarëve të trajnuar | Zero (0) | Njëzetë (20) | 20 zyrtarë të trajnuar | Zhvillimi trajnimeve të stafit për përdorimin e sistemit të evidencës penale | 1400 € (kodi buxhetor 13410) | Ligji për Sistemin Qendrorë të Evidencës Penale të Kosovës. | TM4 |
| | Numri i zyrtarëve të pranuar | 1495 | 50 | Kompletimi agjencisë me staf korrektues sipas ligjit të ri | Rritja e numrit të zyrtarëve korrektues | Kodi buxhetor | Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Korrektues 2023-2027 | TM4 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Numri i zyrtarëve të trajnuar | 50 | 100% | Ngritja e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të agjencisë lidhur me sjelljen dhe abuzimin me substanca psikotrope | Zhvillimi dhe avancimi i kapaciteteve njerëzore lidhur me trajtimin e të burgosuve në lidhje me sjelljen dhe abuzimin e substancave psikotrope | 1000 € (kodi buxhetor 13410) | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 | TM4 |
| 3. Ndërtimi dhe rehabilitimi i objekteve të Shërbimit Korrektues të Kosovës | Zhvillimi i procedurës së tenderimit | | | Kontrata e lidhur për ndërtim | Ndërtimi Qendrës Korrektues për Femra në Lipjan | 2,785,000 € | Plani Zhvillimor Sztrategjik i Shërbimit Korrektues 2023-2027 | TM4 |
| | Renovimi i pavijonit 2 në Qendrën Korrektuese Dubravë | Vlerësimi për renovim | Projekti i perfunduar | Përfundimi i renovimit | Funksionalizimi i pavijonit 2 | Buxheti i Shërbimit Korrektues të Kosovës | Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Korrektues të Kosovës 2023-2027 | TM4 |
| | Projekti i përfunduar | Finalizimi ndërtimit | Përfundimi i projektit | | Ndërtimi i shtëpisë për nëna me fëmije në kuadër të Qendrës Korrektuese për Femra | Buxheti i Shërbimit Korrektues të Kosovës | Plani Zhvillimor Strategjik i Shërbimit Korrektues të Kosovës 2023-2027 | TM4 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zgjerimi i hapësirave në Institutin e Psikiatrisë Feronzike | Finalizimi i Ndërtimit | Projekti i perfunduar | Rritja e kapaciteteve pranuese | Zbatimi i vendimeve të gjykatave me rastin e shqiptimit të masave për trajtim të detyrueshëm me ndalim | Buxheti i Shërbimit Korrektues të Kosovës | Autorizimi për zhvillimin e procedurave të prokurimit | TM3 |
| 4. Ngritja e nivelit të sigurisë. | Përqindja e kamerave të instaluara në institucionet korrektuese | 82 % | 7% | Mbulimi i hapsirave kyqe me sistem të monitorimit përmes kamerave | Instalimi i vazhdueshëm i kamerave në institucionet korrektuese | Buxheti i Shërbimit Korrektues të Kosovës | Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026 | TM3 |
| | Realizimi i bastisjeve me njësinë K9 | 0 bastisje të realizuara | 10 bastisje me njësinë K9 | Luftimi i kontrabandës | Ngritja e nivelit të sigurisë | Kosto Administrative | Ligji nr.08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës | TM3 |